



A K T - T H E M E L I M I

Për krijimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Mi-Le-Ge-H” sh.p.k

Ilir HASA,i biri i Hysniut,lindur me 1970 ne Durres,me banim ne Durres,ne adresen rruga “Mujo Ulqinaku”,Pallati K-S,2002,madhor,me zotesi te plete juridike,me pasaport nr. Z 1368075.

Personi i mesipërm, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar me vullnetin e tij të lirë, në zbatim të nenit 37 e vijues të Ligjit Nr. 7638, datë 19.12.1992 “Për shoqëritë tregtare”, dhe Ligjit Nr. 7667 “Për regjistrin tregtar”, datë 28.01.1993 vendosi të krijojë një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të shënuara me poshtë:

NENI 1

Krijohet Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Mi-Le-Ge-H” sh.p.k e përbëre nga ortaku i vetëm Ilir HASA. Ortak i vetem i Shoqërisë është zoti Ilir HASA.

NENI 2

Selia e Shoqërisë është në Republikën e Shqipërisë, qyteti i Durrësit:rruga “Mujo Ulqinaku”,Pallati K-S,2002 .

NENI 3

Shoqëria është person juridik privat, e cila i nënshtronet Legjislacionit Shqiptar për veprimtarinë tregtare që do të zhvillojë në Republikën e Shqipërisë.

NENI 4

Shoqëria “Mi-Le-Ge-H” sh.p.k, do të ushtrojë veprimtarinë e saj në këto fusha:

- ne fushën e hapjes dhe funksionimit te linjave te qepjes dhe perpunimit te konfekSIONeve.
- Import dhe export te lendeve te para si stofra,lekure,enkelite,e aksesore te tjere ne funksion te prodhimit te konfekSIONeve.
- Import te makinerive per prerje,qepje,hekurosjee amabalazhimi te konfekSIONeve
- Qepje konfekSIONesh me material te porositesit ose me material te vete shoqerise.
- Prodhim e tregetim me pakice ose shumice te artikujve tekstile te prodhuar ne linjat e saj ose te marre nga te trete,per llogari te saj ose te te treteve.
- Shoqerija do te operoje ne import dhe tregtim te makinave ,pjese kembimi,goma, paisje elektro-shtepijke,hidrosanitare,elektrike etj.
- Tregtimin e arikujve industriale, ushqimore si dhe tregetimin e tyre me shumice e pakice.

NENI 5

Për kryerjen e veprimtarisë së saj Shoqëria do të lidhë kontrata dhe do të hyjë në marrdhënie me persona juridikë dhe fizikë, vendas dhe të huaj, me banka dhe institucione financiare shqiptare. Shoqëria ka të drejtë të punësojë specialistë dhe punëtorë duke nënshkruar kontrata pune në pajtim të plotë me dispozitat e Kodit të Punës.

NENI 6

Shoqëria do të funksionojë për një periudhe të pacaktuar kohore.

NENI 7

Kapitali themeltar i Shoqërisë në para është 100.000 lekë të depozituara ne banke: Ilir HASA , 100% .

NENI 8

Kuotat e pjesëmarrjes në kapital janë të gjitha të emërtuara dhe të pandashme. Kuota më e vogël është 1000 lekë. Cdo kuotë prej 1000 lekë i takon e drejtë e një vote.

NENI 9

Ortaku i vetem dhe të punësuarit në Shoqëri janë të detyruar të marrin të gjitha masat për rritjen e kapitalit të Shoqërisë, të ruajnë sekretet e veprimtarisë së Shoqërisë dhe të dhënat që marrin në mënyrë konfidenciale.

NENI 10

Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- Ortaku i vetem.
- Administratori i shoqerise.

NENI 11

Ortaku i vetem është organi më i lartë i Shoqërisë që shqyrton dhe vendos për cdo problem. Për cdo mbledhje mbahet një procesverbal. Kur Ortaku shqyrton cështje të rëndësishme, procesverbali mund të mbahet nga një noter ose avokat, i cili redakton me këtë rast procesverbalin dhe përgatit projektvendimet që do të miratohen pas analizës së problemit nga Ortaku i vetem.

NENI 12

Administratori emrohet nga Ortaku i vetem dhe kryen te gjithe veprimet ne interes te shoqerise(sipëas percaktimit te ligj).

Administratori nuk ka te drejte te ushtroje aktivitet qe te konkuroje me ate te shoqerise ose te marri pjese si ortak ne shoqeri te tjera konkurese,me perjashtim kur autorizohet nga Ortaku i vetem.

NENI 13

Mbledhjet e zakonshme të Shoqërisë bëhen një herë në vit ndërsa të jashtëzakonshmet, sa herë lind nevoja me kërkesë të Ortakut te vetem ose të ekspertit kontabël të autorizuar me pëlqimin e Ortakut.

NENI 14

Vendimet merren sipas kushteve të përcaktuara në STATUT.

NENI 15

Vendimet e Shoqërisë janë të detyrueshme edhe për personat që nuk kanë marrë pjesë në mbledhje, kur vendimi është i miratuar nga Ortaku i vetem.

NENI 16

Ortaku i vetem i Shoqërisë është i përcaktuari në STATUT. Ortaku i vetem përfaqëson Shoqerinë sipas kompetencave që i ka dhënë STATUTI.

NENI 17

Ortaku i vetem përgjigjet civilisht ndaj Shoqërisë dhe të tretëve. Ortaku i vetem i Shoqërisë "Mi-Le-Ge-H" sh.p.k është Ilir HASA.

NENI 18

Të drejtat dhe detyrat e Ortakut te vetem të Shoqërisë caktohen në STATUT.

NENI 19

Ortaku i vetem ka të drejtë të emërojë ekspert kontabël të autorizuar.

NENI 20

Veprimtaria financiare e Shoqërisë mbyllt më 31 dhjetor të cdo viti.

NENI 21

Të ardhurat neto që realizohen pas zbritjes së shpenzimeve, të detyrimeve financiare dhe të rezervës së domosdoshme, ndahen si fitime në formë dividentësh, në raport me pjesët e kapitalit themeltar që zotëron.

NENI 22

Mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të KONTRATËS zgjidhen nga Ortaku i vetem. Kur nuk arrihet mirëkuptimi ndërmjet palëve cështjet i parashtronen një avokati, rekomandimet e të cilit kanë vlerën e një zgjidhje paraprake. Në rast së palët nuk janë dakort me këto rekomandime mund t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë sipas dispozitave të K.Pr.C.


NENI 23

Herm

AKTI I THEMELIMIT në përshtatje me ndryshimet e Legjislacionit e të kushteve që determinuan lidhjen e saj, mund të ndryshojë me vendim të Ortakut. STATUTI është pjesë përbërëse e AKTIT TË THEMELIMIT dhe i bashkëlidhet asaj.

ORTAKU I VETEM

Ilir HASA




REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
DHOMA E NOTERISÉ TIRANË
Nr. 1594 Rep. Nr. Kol.

VËRTETIM

Sot, me datën 12.06.2007 u paraqit para meje Gentiana BRATI, notere në zyrën e noterisë Tiranë, bulevardi "At Gjergj Fishta", Z. Ilir HASA, me pasaport Nr. Z 1368075, njohur prej meje personalisht, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar i cili deklaroi se jashtë kësaj zyre notariale ka hartuar Aktin e themelimit te shoqerise të mësipërme, i cili u nënshkrua rregullisht para meje dhe unë noterja e vërtetoj sipas ligjit.

NOTERE

Gentiana BRATI





STATUT

I

Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "MI-Le-Ge-H" sh.p.k me Ortak te vetem:

Ilir HASA,i biri i Hysniut,lindur me 1970 ne Durres,me banim ne Durres,ne adresen :rruga "Mujo Ulqinaku",Pallati K-S,2002,madhor,me zotesi te plote juridike,me pasaport nr. Z 1368075., përkatesisht me detyrën e Administratorit të Shoqërisë së sipërpërmendur.

Me vullnetin e tij të lirë, në pajtim të ligjit Nr. 7638, datë 19.12.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar" vendosi të krijoje një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas kushtëve të poshtëshënuara në këtë STATUT, të cilat përbijnë dispozitat kryesore të kësaj Shoqërie.

KAPITULLI 1

**Krijimi, emri, selia, qëndra e veprimtarisë, objekti
dhe kohëzgjatja e Shoqërisë.**

NENI 1

Krijohet Shoqëria me përgjegjesi të kufizuar "Mi-Le-Ge-H" sh.p.k me seli në Republikën e Shqipërisë, qyteti i Durres,ne adresen :rruga "Mujo Ulqinaku",Pallati K-S,2002.

NENI 2

Shoqëria ka të drejtë të hapi njësi të reja në të gjithe territorin e Republikës së Shqipërisë. Shoqëria janë pjesë e Shoqërisë, veprimtaria e tyre i nënshtrohet STATUTIT të Njësitë e reja janë pjesë e Shoqërisë, veprimtaria e tyre i nënshtrohet STATUTIT të Shoqërisë dhe ushtrohet brenda kufijve të kompetencave të dhëna nga Administratori i sipërpërmendur.

NENI 3

Shoqëria "Mi-Le-Ge-H" sh.p.k do të funksionojë si shoqëri tregtare dhe do të ushtrojë veprimtari në këto fusha:

- ne fushën e hapjes dhe funksionimit te linjave te qepjes dhe perpunimit te konfeksioneve.
- Import dhe export te lendeve te para si stofra,lekure,enkelite,e aksesore te tjere ne funksion te prodhimit te konfeksioneve.
- Import te makinerive per prerje,qepje,hekurosje amabalazhimi te konfeksioneve
- Qepje konfeksionesh me material te porositesit ose me material te vete shoqerise.
- Prodhim e tregetim me pakice ose shumice te artikujve tekstile te prodhuar ne linjat e saj ose te marre nga te trete,per llogari te saj ose te te treteve.
- Shoqerija do te operoje ne import dhe tregetim te makinave ,pjese kembimi,goma, paisje elektro-shtepijke,hidrosanitare,elektrike etj.
- Tregtimin e arikujve industriale, ushqimore si dhe tregetimin e tyre me shumice e pakice.

NENI 4

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë të pacaktuar kohore nga dita e fitimit të personalitetit juridik.

NENI 5

Shoqëria ka të drejtë të lidhe kontrata dhe të hyje në marrveshje me persona të tjerë fizikë osë juridikë, vendas ose të huaj.

NENI 6

Shoqëria "Mi-Le-Ge-H" sh.p.k mund të pushojë së funksionuari kur:

1. në cdo moment kohor, me vullnetin e lire të Ortakut te vetem;
2. me pamundesinë objektive të plotësimit të detyrave të fiksuar në KONTRATË, pamundësi e cila rezulton nga vullneti i Ortakut te vetem, bazuar në rezultatet ekonomiko-financiare të kësaj veprimtarie;
3. me humbjen e 2/3 të pjesëve të kapitalit;
4. me falimentimin e Shoqërisë.

Për cdo rast KONTRATA zgjidhet sipas vullnetit të vetë Ortakut te vetem , ose duke ju drejtuar Gjykatës.

KAPITULLI 2

Kapitali themeltar, bilanci dhe të ardhurat

NENI 7

Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet:

.në vlerë në të holla e cila është 100.000 lekë, të depozituara pranë Bankes . Kuota më e vogël është 1000 lekë. Ilir Hasa është zotërues i 100% të kuotave.

- dhe në vlerë materiale, në natyrë, ku kapitali zotërohet nga Ortaku i vetem Z. Ilir HASA .

NENI 8

Të ardhurat e Shoqërisë i kalojnë Ortakut te vetem të Shoqërisë në vlerën e kuotave që ai zotëron.

KAPITULLI 3

Organet drejtuese të Shoqërisë

NENI 9

Organet drejtuese të Shoqërisë "Mi-Le.-Ge-H" sh.p.k janë:

- . Ortaku i vetem.



-Administratori i shoqerise .

NENI 10

Ortaku i vetem është organi më i lartë i Shoqërisë. Ai ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vendosë për cdo cështje. Vendimet e tij janë të detyrueshme për Shoqërinë.

NENI 11

Ortaku i vetem merr vendime për:

- ndryshimet në STATUT ose në KONTRATË;
- zgjerimi i Shoqërisë me filiale;
- tjetërsimi ose venia në hipoteke të pasurisë së paluajtshme;
- lidh kontrata në emër të Shoqërisë me persona fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj sipas kompetencave që i janë dhënë në STATUT.

NENI 12

Ortaku i vetem organizon dhe drejton gjithë veprimitarinë e Shoqërisë. Ai kryen sidomos këto detyra:

- Ndjek zbatimin e kontratave të lidhura nga vetë ai;
- 1. Përfaqëson Shoqërinë në Gjykatë, Arbitrazh, organet shtetërore, publike dhe private;
- 2. Ndjek operacionet e veprimitarisë së Shoqërisë dhe firmos dokumente që kanë të bejnë me qarkullimin civil si fatura, ceqe, kambiale dhe cdo lloj dokumenti tjetër financiar ose bankar. Kontrollon veprimitarinë e Shoqërisë, harton raportet e administrimit, inventaret dhe llogaritë vjetore;
- 3. Ortaku i vetem përcakton strukturën e organizimit të Shoqërisë, emëron dhe shkarkon nga detyra të punësuarit në Shoqëri, duke respektuar kërkesat e Legjislacionit të Punës;
- 4. Ortaku i vetem është individualisht përgjegjës ndaj Shoqërisë, ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve të STATUTIT dhe për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

NENI 13

Administratori i shoqerise emrohet nga Ortaku i vetem dhe kryen detyrat e ngrakuara nga Ai. Asnjë veprim i kryer prej tij nuk duhet te bier ndesh me interesat e shoqerise. Ai vepron dhe kryen detyurat sipas percaktimit ne ligj.

KAPITULLI 4

Dispozita të përgjithshme

NENI 14

Shoqëria ka emrin e saj dhe llojin e saj, logon e saj si dhe vulën e saj.

NENI 15

Shoqëria vepron në bazë të ligjeve, STATUTIT dhe KONTRATËS. Ortaku i vetem ka të drejtë të bejë interpretimin e dispozitave të STATUTIT dhe të KONTRATËS gjatë



zbatimit të tyre në praktikë. Për cdo cështje që nuk është shprehur në STATUT ose në KONTRATË, Ortaku i vetem do t'i referohet ligjit të vecantë që ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur rasti.


NENI 16

Shqëria vepron si person juridik privat nga dita e rregjistrimit në Rregjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë, duke qenë e detyruar që për datën e fillimit të veprimtarisë të njoftojë dhe organet tatimore.

NENI 17

STATUTI u përpilua në katër kopje me fuqi juridike të barabartë, një për t'u depozituar tek noteri, një në Gjykatë, një në zyrën e tatimeve dhe një kopje ruhet në selinë e Shoqërisë.

ORTAKU I VETEM
Ilir HASA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
Nr. 1595 Rep. Nr. Kol.

VËRTETIM

Sot, me datën 12.06.2007 u paraqit para meje Gentiana BRATI, notere në zyrën e noterisë Tiranë, bulevardi "At Gjergj Fishta", Z. Ilir HASA, me pasaport Nr. Z 1368075, njojur prej meje personalisht, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar i cili deklaroi se jashtë kësaj zyre noteriale ka hartuar Statutin e shoqerise të mësipërme, i cili u nënshkrua rregullisht para meje dhe unë noterja e vërtetoj sipas ligjit.

NOTERE

Gentiana BRATI

